



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

8 Marsi, Manastirliu: Rritje page për mjekët dhe infermierët

2018-03-08 15:26:00



“Jeni shembuj frymëzimi sepse ja dilni që çdo ditë të shpëtoni jetë dhe ky është më i larti i misionëve!”

Tiranë, 8 Mars - Liridona Cani është infermiere në qendrën shëndetësore Ostren në Bulqizë. Vetëm pak ditë më parë shpëtoi një foshnje 6 muajsh pasi kishte ecur për orë të tëra mes dëborës. “Unë bëra atë që me siguri do të bënte secila prej jush që jeni sot këtu, shpëtova një jetë”, tha Liridona në takimin e organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu me mjekët dhe infermieret e urgjencave mjekësore nga e gjithë Shqipëria.

“Jam e bindur se Liridona, e cila eci me orë në këmbë, në mes të dëborës, në një fshat të thellë të Bulqizës, siç na tregoi, nuk është menduar dy herë për të sfiduar vështirësitë ekstreme, për t’i shpëtuar jetën foshnjës 6 muajshe. Moshë e saj e re më mbush me besim se ka ende shumë mjekë, infermierë që i janë dedikuar këtij profesioni me mish e me shpirt”, tha Ministria Manastirliu.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale deklaroi gjithashtu se mbështetja e qeverisë për stafin mjekësor do të jetë maksimale. “Zemra ma donte të ishim të gjitha bashkë sot, të 12 mijë e 47 punonjësit gra të sistemit tonë shëndetësor për t’u përgjatur përballë punës tuaj. Ju meritoni më të mirën dhe me shumë përgjatur ju them se mbështetja ime personale por mbi të gjitha e qeverisë shqiptare nuk do të mungojë. Ne do të vijojmë të përmirësojmë kushtet e punës në qendrat tona shëndetësore, në spitalet tona, që ju ta kryeni më mirë profesionin tuaj. Do të vijojmë me politikën e rritjes së pagave edhe në vitin 2018 për personelin mjekësor dhe infermierë. Angazhimi ynë është i përditshëm në këtë drejtim dhe për një arsye tjetër, sepse ju jeni shembuj frymëzimi jo vetëm sepse keni lartësuar pozitat e grave në shoqërinë shqiptare por sepse ja dilni që çdo ditë të shpëtoni jetë dhe ky është më i larti i misionëve”, tha Manastirliu.

Ministria Manastirliu u shpreh gjithashtu se që nga vitin 2019 do të plotësohen nevojat me mjekë specialistë në shumë spitalet të vendit.

“Një ditë më parë takova brezin e parë të specialistëve që pritet të diplomohen në vitin 2019, shumica prej tyre vajza, gra, që kanë vendosur të shërbejnë në spitalet ku ka nevojë për mjekë të specializuar. Disa prej tyre punojnë edhe në sektorin privat aktualisht por kur l pyeta nëse do të duan të punojnë në spitalet rajonale në përfundim të specialiteteve, nuk kishin dyshime që do bënin këtë zgjedhje. Kjo është sa frymëzuese aq edhe shpresëdhënëse për shëndetësinë që duam të ndërtojmë, së bashku”, tha Manastirliu.

Ministria Manastirliu dhe zv/Ministret e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ndanë disa çmime mirënjohje për mjekët dhe infermieret e vitit, të cilat i janë dedikuar këtij profesioni me përkushtim e sakrificë.

U nderua me çmimin e mirënjohjes Liridona Cani, infermiere në qendrën shëndetësore Ostren në Bulqizë; dr. Zana Hoxha, mjekë gastrohepatolog në spitalin e Shkodrës; dr. Gjyzedë Zalla,

pediatre në spitalin e Durrësit; Sadete Gjeçi, infermiere e urgjencës në spitalin universitar të Traumës dhe prof. Eli Foto, shefe e shërbimit infektik në QSUT.

###